

V E N D I M
Nr.476, datë 29.7.1998

**PËR OBJEKTET DHE MJETET KRYESORE TË AGJENCISË SË MBROJTJES SË
MJEDISIT**

Në mbështetje të ligjit nr.8364, datë 2.7.1998 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7664, datë 21.1.1993 "Për mbrojtjen e mjedisit" ", me propozimin e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave dhe Ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Mjetet kryesore dhe objektet e Komitetit Kombëtar të Mjedisit, i kalojnë Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit.

2. Numri i punonjësve të parashikuar për Komitetin Kombëtar të Mjedisit, në strukturën organizative të Ministrisë së Shëndetësisë, i kalon Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit.

3. Ngarkohet Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të hartojë dhe të paraqesë për miratim, pranë Kryetarit të Këshillit të Ministrave, strukturën organizative të saj.

4. Ngarkohet Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë, Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano